REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 845/20
Datë/Datum. 23.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *020/KEK-20-4358-1-1-1*

Sa i përket tenderit për *Furnizim me gëlqere të hidratizuar*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GRAMI shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Xhorxh Bush no 19
(Adresa)
Prishtine *10000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
+38343555141
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Gramoz Ymeri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
~~info@grami-ltd.com~~
(Adresa elektronike)

23.10.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

19.08.2020 Njoftimi per kontrate
27.10.2020 Afati per dorezim te ofertave
24.09.2020 Kërkesë për rishqyrtim
01.10.2020 Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim
08.10.2020 Kerkese per rishqyrtim
13.10.2020 Pergjigja ne kerkese per rishqyrtim
23.10.2020 Ankesa ne OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

Hapja eshte parapare per date 27.10.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [+] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Tutje i referuar si" LPP apo Ligji i Prokurimit), duke shpallur Njoftimin per Kontrate per Furnizim me Gelqere te Hidratizuar pa siguruar fondet. **Neni 1. Qëllimi.** **Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.** **Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.** **Neni 9. Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur** **Neni 16 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim** **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave.** **Neni 60. Kriteret per dhenjen e kontrates.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Edhe pas plotesimit te DT te dates 01.10.2020, AK **nuk ka siguruar** fonde-buxhet te mjaftueshem per kete AP ashtu siq parashef LPPK, më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Bazuar ne ofertat e pranuara nga prodhuesit e Gelqeres te Hidratizuar (te cilet ne regjion jane te paket) dhe krahasuar me shumen - buxhetin e parapare per kete AP nga AK qarte shifet se ky AP do te deshtoj-anulohet me rastin e hapjes te ofertave pasi qe te gjitha ofertat do te tejkalojn substancialisht buxhetin e parapare per kete AP.

Nuk dihet qellimi, pse AK ka zvogluar dukshem buxhetin per kete AP ne krahasim me te gjitha kontratat e gjertanishme te furnizimit me Gelqere te Hidratizuar kur te gjitha **cmimet ne treg kane pesuar ngritje** e jo ulje, e sidomos tani duke llogaritur sitaten me pandemine Covid 19, kur tani cdo gje eshte me e veshtire duke llogaritur transportin, poashtu prodhuesit punojne me staf dhe prodhim te redukuar dhe shume rrethana tjera qe kane quar ne ngritje te cmimeve.

Vazhdimi i keti AP ne kete menyre pa buxhet te mjaftueshem, demton dhe deskrediton OE por njekohesish lene dyshime edhe per manipulime te ndryshme ne rast te anulimit te tenderit (duke zbuluar cmimet dhe prodhuesit).

Gjitheashtu demin me te madh do ta pesoj vet AK, pasi qe tenderi automatikisht do te anulohet (per shkak te buxhetit jo te mjaftueshem) dhe do te detyrohet qe furnizimin ta beje me kuotime te cilat do te rrisin cmimin e furnizimit pasi qe Kontrata per furnizim te rregullt ka perfunduar dhe procedura e perseritur pas anulimit te tenderit do te stergjatet.(per shkak te rregullave te parapara me Ligj per vlera te medha dhe do te vie ne pytje edhe mungesa e gelqeres per procesin teknologjik siq ka ndodhur edhe me pare, ne te kalueren).

Nga DT (FDT) ku eshte parapare sasia dhe vlera e parapare per njisit TC A dhe TC B shifet edhe nji diskrepance ne mes te vlerave te parapara -buxhetin per njerin divizion dhe tjetrin. Deri sa buxheti i TC B eshte 109.72 euro/ton, ai i TC A eshte 100.00 Euro/ton. Per te njejtin kualitet dhe te njejtat karakteristika teknike dhe per te njetin AK.

Nuk qendron arsyetimi-fakti i AK se cmimi i pergjithshem i gelqeres nga buxheti i permirsuar eshte me i larte se kontrata aktuale siq e ka cekur AK , por eshte me i vogel, pra, nuk eshte 104.86 euro/ton (sepse 995000€/9600ton=103.64€/t) e qe eshte i pamjaftueshem per te kaluar ofertat.

OE Grami edhe ne dy Kerkesat per Rishqyrtim i ka dhene arsyet per rritjen e cmimit duke u bazuar ne cmimin aktual te prodhuesve dhe rrethanave te krijuara.

I njejti rast ka ndodhur edhe me nje AP tjeter te shpallur nga po i njejti AK per Furnizim me Hidroksid Natriumi, ku buxheti i planifikuar ka qene shume ma i ulet se ofertat e dorzuara si dhe berza e ngarkuar ne DT nga AK

Fakte: Cmimi i buxhetit i parapare ne DT ka qene 284.50 euro/ton, ndersa cmimin e Berzes te cilen e ka derguar AK ka qene 352.19 euro/ton duke mos llogaritu edhe premin, qe i bie 24 %, me i vogel se buxheti, kurse nese llogaritet ne baze te ofertave te dorzuara rrethe 43% me i vogel.

Cka faktikisht me rastin e dorzimit te ofertave eshte anuluar tenderi per buxhet jo te mjaftueshem me arsytim se te gjitha ofertat "substancialisht kane tejkaluar buxhetin e parapare"

Prandaj edhe me rastin e AP per furnizmi me Gelqere te Hidratizuar do te ndodhe e njejta gje me kete buxhet.

Nuk qendron pretendimi i AK se OE ankues po e shtyn afatin e dorzimit te ofertav per arsye se gelqerja eshte e domosdoshme per procesin e prodhimit.
Por eshte e verteta tjeter ku OE ne Kerkesen per Rishqyrtim ka cekur: se me vazhdimin e keti AP ne kete menyre (me kete buxhet aktual) do ta sjelle anulimin automatik te tenderit dhe ritenderimin e keti tenderi ku do te zgjaten procedurat e tenderimit edhe me teper dhe do te ndihet mungesa e gelqeres per prodhimin e energjis elektrike (shifni Kerkesat per Rishqyrtim.

Buxheti i parapare me i larte nuk do te thot se OE do ta shfrytzojn tavanin e buxhetit sepse konkurenca eshte e hapur dhe kriter per shperblim me kontrate eshte cmimi me ulet.

Kerkojm nga PSH i OSHP qe te pranoj ankesen e OE si te arsyshme dhe te bie Vendim qe te kerkoj nga AK qe te beje rivlersimin e buxhetit, rrespektivisht rritjen reale te buxhetit duke pasur parasyqsh cmimet e tregut.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do tepercaktohen pas analizes te eksperve

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*